

VENDIM
Nr. 151, datë 14.10.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELVA 2001”
SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“MIVAS” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1940 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Elva 2001” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 92/11, datë 8.10.2019, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Elva 2001” sh.a, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC “Mivas” me kapacitet të instaluar 1940 kW,

konstatoi se:

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 604 prot, datë 1.10.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.

- Aplikimi i shoqërisë “Elva 2001” sh.a, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2; pika 4.1.3; pika 4.1.4, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, është një subjekt tregtar i krijuar me vendimin nr. 25441 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe mban numër identifikimi NUIS: K12809402J.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, është mbajtëse e Miratimit Përfundimtar për ndërtimin e objektit, hidrocentrali “Mivas” me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan me nr. 2657/2 prot, datë 27.12.2017, mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën për ndërtimin e objektit, hidrocentrali “Mivas”, me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan me nr. 5 rep, nr. 3/3 kol. datë 25.1.2018.

- Referuar afateve të vënies në punë të veprës, sipas kontratës sipërcituar, mbajtësi i miratimit merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 21 (njëzetë e një) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.

- Rezulton se shoqëria ka vijuar me aplikimet për pajisjen me lejet në institucionet përkatëse.
- Shoqëria, në aplikimin e saj, parashikon të vërë në punë Hec-in në datë 1.12.2019.

Për mungesën e dokumentacionit të konstatuar që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “g”: dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti, kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti).

- Subjekti ka depozituar Kontratën “Për dhënie në përdorim të tokës pa frut” me nr. 1728 prot, datë 6.7.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe shoqërisë “Elva 2001” sh.a, e cila në nenin 6 të saj ka të parashikuara afatin, i cili rezulton se ka përfunduar më 6.7.2019, me të drejtë ripërsëritje, dhe për këtë shoqëria do të bëjë me dije nëse ka nënshkruar një kontratë të re.

- Neni 9, pika 4.1.1 (Të dhëna specifike për HEC-in)

- Në këtë formular subjekti ka lënë pa plotësuar, pikën 3 të tij (vendndodhja numri i regjistrimit të pronës); pikën 8 (gjatësia e kanalit të derivacionit); pikën 11 (numri i njësive gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës); pikën 16 (rendimenti); pikën 19 (jetëgjatësia e pritshme e centralit).

- Neni 9, pika 4.1.4, germa “e” (Miratim i projektit të zbatimit nga organi i caktuar me ligj)

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Kontrata për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Mivas” me kapacitet prodhues 1.940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan dhe Autoritetit Kontraktues, me nr. 5 rep. dhe nr. 3/3 kol, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka një afat 49-vjeçar, por në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Elva 2001” sh.a, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti